



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH



Në bazë të nenit 14 shkronja s), neni 40, paragrafi 40.2 shkronja i), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28), neni 15 i Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, neni 14 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e Komiteteve konsultative në Komuna, neni 32 i Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 i dt. 11.09.2008, në seancën e XII-të të Kuvendit të Komunës së Dragashit e mbajtur me dt. 18.12.2024 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miratohet ky:

V E N D I M

PËR PAGESËN E KOMITETEVE TË THEMELUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS

Neni I

Miratohet vendimi për pagesën e komiteteve të themeluara nga Kuvendi i Komunës.

Neni II

Anëtarët e komiteteve të përhershme, komiteteve konsultative dhe komiteteve tjera (KKSB), të themeluara nga Kuvendi i Komunës do të paguhen ashtu siç parashihet me Udhëzimin Administrativ (MPL) Nr.05/2020 dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016, për procedurën e themelimit dhe funksionin e këtyre komiteteve. Pagesa të bëhet retroaktive për të gjitha takimet të cilat janë mbajtur dhe nuk janë paguar sipas legjislacionit në fuqi dhe vendimeve të Kuvendit të Komunës.

Neni III

Për ekzekutimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni IV

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01 nr. 060/01-31085-3124

Datë: 18.12.2024

Kryesuesja e Kuvendit

Arijeta Skeraj

